



SHOQATA PRO-EKSPORT ALBANIA

Nr. 25 Prot.

Tiranë, më 19 Dhjetor 2020

Lënda: Mendim/ide mbi draft rregulloren që u është shpërndarë për konsultim subjekteve politike.

Z. Ilirjan Celibashi

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

I nderuar Zoti Celibashi,

Ne jemi Shoqata Pro-Eksport Albania, përfaqësuesja unike e 700 fabrikave të industrisë së veshjeve dhe këpucëve, industri që në vitin 2019 jepte mbi 40 përqind të eksporteve dhe punësonte mbi 70 mijë punonjës.

Duke vlerësuar vlerën e shtuar që po jepni në drejtimin e një institucioni thelbësor si Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, një organ i përhershëm që përgatit, mbikqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe me referendumet dhe shpall rezultatet e tyre, mbështesim plotësisht draft rregulloren që u është shpërndarë për konsultim subjekteve politike.

Duke qenë grupimi më i madh, në përfaqësim, me impaktin ekonomik dhe social që ka, do të dëshironim që edhe ne të jepnim mendimin tonë mbi një pikë të rëndësishme e në mbështetje të draftit Tuaj:

- Të pezullohen të gjitha inspektimet/kontrollet nga Organet Inspektuese (Tatimet, Inspektoriati i punës, Doganat, Inspektoriati i mjedisit e të tjerë), për një afat kohor 4/5 muaj para zgjedhjeve dhe 4/5 mbas daljes së rezultateve të tij. E gjitha kjo në frymën e mosndikimit paraprak ose retro te tij. Kjo e mbështetur edhe në eksperiencat e mëparshme të ndodhura siç ishte Ligji Nr. 39/2014 Për faljen e dënimeve administrative në formën e gjobave, të vëna në bazë të kontrollove dhe verifikimeve Tatimore për periudhën 1 Mars deri më 31 Gusht 2013.

Me respekt dhe besim se kjo kërkesë do të merret parasysh nga Ju.

Edvin PRENÇE

Kryetar i Pro-Eksport Albania

PRO-EKSPORT ALBANIA

Cel:00355/698364328

Email: kryetari@fason.al

Web: www.fason.al

Adresa: Rruga 5 Maji, Ndertesa 82 - Kati i 3
Tirane, Shqiperi